



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1968
Prot

Shkodër, më 20.12.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër".

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër".

Duke Ju urreuar punë të mbarë!

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ /2023

**“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITSHME TË PLAZHEVE TË
LEJUARA NË TERRITORIN BREGDETAR TË NJËSISË ADMINISTRATIVE
VELIPOJË, BASHKIA SHKODËR”.**


Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës _____, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr.8743, date 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; ligjit nr.9251, date 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr.171, date 27.03.2019 “Për miratimin e rregullorës “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar; VKM nr.321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të tetritorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 6495, dt 31.10.2023 si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratoj hartën përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin bregdetar të njësisë administrative Veliqojë, Bashkia Shkodër”, sipas materialit hartografik bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Benel BECI

Za Kryetar




Drejtorja Turizmit



Drejtorja Studimeve, planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve



Drejtorja Juridike





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

RELACION

Drejtuar: Këshillit Bashkiak.

PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA NË TERRITORIN BREGDETAR TË NJËSISË ADMINISTRATIVE VELLIPOJË, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin” të ndryshuar; ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; VKM nr. 171, datë 27.03.2019, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar dhe shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.6495, datë 31.10.2023.

Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik në plazhin e Velipojës dhe të Baks Rrjollit dhe në zbatim të VKM nr. 171 dt. 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar, po ju paraqesim për miratim hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara të Velipojës dhe Baks Rrjollit të hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit sipas kriterëve të cituara në VKM e mësipërme. Në hartën bashkëlidhur janë të pasqyruara të gjitha pikat të cilat citohen në pikën 1 të nenit 4 të VKM 171/2019, si dhe duke u nisur nga kërkesa e një subjekti është shtuar edhe një zonë për shfrytëzimin e lojërave ujore, si më poshtë:

- a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi;
- b) hapësirat e plazhit publik;
- c) vendndodhjen e kullave dhe pikave të vrojimit;
- c) zonën e çadrave;
- d) zonën e shërbimeve;
- dh) hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrethuar me bova);
- e) vendbazimet e mjeteve lunduese dhe korridoret e lëvizjes së tyre;

- ë) vendbazim për lojra ujore;
f) zonat rekreative etj.

Gjithashtu janë pasqyruar dhe kriteret e pikës 2 të nenit 4 të VKM 171/2019 të ndryshuara me VKM nr. 659, datë 10.10.2022:

“...Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik do të bëhet proporcionalisht, sipas raportit 70%/30% dhe në mënyrë perpendikulare me vijën bregdetare. Hapësira e çdo plazhi (publik ose privat) kufizohet me vijën bregdetare.”

Theksojmë se këtë vit raporti i plazheve publike në krahasim me ato të menaxhuara është mbi 35%.

KRYETAR

Benet Beci

**Drejtorja Studimeve, Planifikimit
dhe Koordinimit të Investimeve**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA SHKODËR

HARTA E PËRGJITHSHME PËR PLAZHET E LEJUARA PLAZHI RRJOLL

